

VENDIM
Nr.40, datë 11.1.2012

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.411, DATË 19.5.2010 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE TIPIN E
FORMULARIT TË LEJES SË LEGALIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.411, datë 19.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje, vendosin kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi. Vendimi, i cili shoqërohet me aktin përkatës, të argumentuar, administrohet si pjesë përbërëse e dosjes së legalizimit.”.

2. Në pikën 3 bëhen shtesat dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Në fund të shkronjës “a” shtohen fjalët “...dhe të atyre që përjashtohen nga legalizimi.”.

b) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shlyerjes së pagesës sipas shkronjës “ç” të pikës 1, të këtij vendimi, lëshojnë dhe e pajisin subjektin me leje legalizimi për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje;”.

c) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Publikojnë në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit listat emërore të subjekteve, objektet e të cilave pajisen me leje legalizimi, si dhe ia përcjellin ato njërive të qeverisjes vendore, për njoftim dhe publikim;”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Poseduesit e objektit ose subjektet e interesuara, brenda një muaji nga data e publikimit të listës emërore, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, mund të bëjnë ankim administrativ në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t ndaj vendimit/lejes përkatëse të drejtorisë së ALUIZNI-t pranë qarqeve sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

4. Në fund të pikës 6 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, poseduesi mund të ankohet ndaj vendimit të përjashtimit në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t.”.

II. Drejtoritë e ALUIZNI-t pranë qarqeve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përfundojnë shqyrtimin/verifikimin e kërkesave/dokumentacionit të depozituar për legalizim për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje dhe, në bazë të vlerësimit të përmbushjes ose jo të kushteve të kërkuara, të nxjerrin vendimet përkatëse për kualifikimin për legalizim ose përjashtimin nga legalizimi.

III. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha